



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1545 Prot.

Tiranë, më 15.12 2017

VENDIM Nr. 230, datë 13.12.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 30, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, datë 13.12.2017, pasi shqyrtoi Raportin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit, për projektin "*Godinë banimi me 5 kate dhe 1 kat nën tokë*", *Lagja 1, Rruga "Mbretëresha Teuta", Durrës*,-subjekti "REI" sh.p.k.. realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji "A.K.eR." sh.p.k. dhe *Relacionin e verifikimit në terren* nga grupi i punës me antarët e KKA dhe ASHA.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit, për projektin "*Godinë banimi me 5 kate dhe 1 kat nën tokë*", *Lagja 1, Rruga "Mbretëresha Teuta", Durrës*, -subjekti "REI" sh.p.k., realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji "A.K.eR." sh.p.k. dhe *Relacionin e verifikimit në terren* nga grupi i punës me antarët e KKA dhe ASHA.
2. Të ruhen *in situ* strukturat e zbuluara gjatë gërmimit arkeologjik të shpëtimit, duke marrë masat e nevojshme për mosdëmtimin e tyre deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, konform akteve ligjore përkatëse.
3. Investitori duhet kontraktojë një subjekt të licencuar për restaurim, i cili të paraqesë pranë KKA një *Relacion vlerësimi të strukturave të zbuluara, në gjendjen e sotme dhe të sjellë propozimet e tij për variantet e mëposhtme:*
 - a) *Restaurimin dhe integrimin e këtyre strukturave* me zhvillimin e kërkuar, duke ndryshuar projektin ndërtimor, në përshtatje me to.
 - b) Ruajtjen *in situ* të këtyre strukturave, duke mbuluar dhe kthyer territorin në gjendjen e mëparëshme, duke paraqitur projektin për mënyrën e mbulimit, me qëllim mosdëmtimin e tyre.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKA
RUBINA ZOTO